

VENDIM
Nr. 696, datë 26.11.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1178, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME TË EVIDENTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 6, dhe 69, pika 9, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Në zbatim të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës trajton kryesisht ndërtimet pa leje të evidentuara nga vetë institucioni, gjatë proceseve të regjistrimit fillestar, të përmirësimit të zonës kadastrale, ose të evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje. Në momentin e evidentimit në terren, subjekti plotëson formularin e deklarimit të të dhënave të ndërtimit pa leje, të vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës gjatë procesit të evidentimit. Formulari i deklarimit të të dhënave të ndërtimit pa leje është sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Drejtoria vendore e ASHK-së kryen këto veprime:

a) Për ndërtimet pa leje, për të cilat evidenton përfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas neneve 17, pika 1, dhe 69, pika 9, të këtij ligji, njofton zyrtarisht subjektin për përfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit dhe i përcjell faturën për arkëtim për shlyerjen e tarifës së shërbimit në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë. Subjekti duhet të shlyejë pagesën brenda afatit 30-ditor (tridhjetëditor) nga momenti i marrjes dijeni.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës vijon me procedurat administrative për shqyrtimin e dokumentacionit dhe të përmbushjes së kriterëve ligjore të legalizimit të parashikuara në vendimin nr. 1040, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”, të ndryshuar.

b) Për ndërtimet pa leje, për të cilat evidenton mospërfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas neneve 17, pika 1, dhe 69, pika 9, të këtij ligji, del me akt administrativ “Urdhër për evidentimin e mospërfshirjes”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i evidentimit në terren, dhe njofton subjektin për mospërfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit.”.

2. Aneksi 2, “Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje”, zëvendësohet me aneksin 2, “Formulari i deklarimit të të dhënave të ndërtimit pa leje”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FORMULAR I DEKLARIMIT TË DHËNAVE
TË NDËRTIMIT PA LEJE

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: _____ E-mail: _____ Web: _____ Shënim: Lutemi plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë:	PAFËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN Drejtoria Vendore e ASHK _____ Nr. _____ Prot, datë ____ / ____ / ____
---	--

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN/ËT

1. Emër, Atësi Mbiemër: _____
Nr. identifikimi (ID): _____, Nr. cel: _____, Adresa: _____
2. ...

ose

Përfaqësuesi i autorizuar me prokurën nr. _____, datë _____:
1. Emër, Atësi, Mbiemër: _____
Nr. identifikimi (ID) : _____, Nr. cel: _____,
Adresa: _____

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje", kërkoj përfshirjen në fushën e legalizimit të ndërtimit pa leje të llojit:

☒ Objekt, ☐ Shtesë, ☐ Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit me adresë: _____
Rruga, Njësia e vetqeverisjes vendore

Deklaroj se ndërtimi është ngritur në vitin : _____

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Kërkesa shoqërohet (opsionale) nga:
Dokumentacioni i pronësisë mbi truallin: _____
Dokumentacion shoqërues: _____
Kopje të dokumentit të identifikimit _____

Deklaruesi

(Emër Atësi Mbiemër)

Për Drejtorinë Vendore të ASHK-së

(Emër Mbiemër-Firmë)

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe jam i vetdijshëm se në të kundërt do të nënshkrohem i përgjegjshëm penale sipas ligjit.

ASHK i bashkëlidh kërkesës, certifikatën e gjendjes familjare të momentit të aplikimit, të kërkuarit.